

V E N D I M
Nr. 54. datë 16.7.2001

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADIO VENDORE PRIVATE “RADIO 7”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “MEDIA J-7” SH.P.K.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “Media J-7” licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Sefedin Çela